



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
JURIA

Nr. 1310 Prot.

Tiranë, më 02.12.2025

Vendim nr. 76 datë 02.12.2025

Për dhënien e mirënjohjes *Nderi i Akademisë*

tre personaliteteve të shquara

Referuar nenit 10 të *Rregullores për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre*; në mbështetje të Vendimit të Kryesisë nr. 19 datë 24.05.2022 *Për mirënjohjen “Nderi i Akademisë” dhe për kriteret e procedurat e dhënies së saj*; me propozim të komisionit të përhershëm të matematikë-informatikës, në shkresën e SSHNT me nr. Prot. 1692, datë 07.11.2025 (bashkëngjitur) dhe komisionit të përhershëm të artit, në shkresat me nr. prot. 1630, datë 30.10.2025 dhe nr. Prot. 1646, datë 13.11.2025 (bashkëngjitur); pasi konstatoi plotësimin e kriterëve dhe zbatimin e procedurave sipas parashikimeve si më sipër; Juria, në mbledhjen e saj të datës 02.12.2025,

Vendosi:

1. T'i jepet mirënjohja *Nderi i Akademisë* personaliteteve të shquara të artit pamor dhe muzikës, përkatësisht:

- Bashkim Ahmeti, piktor

Me motivacionin:

Artist i shquar i arteve pamore në Shqipëri, me aktivitet të gjerë krijues në SHBA; protagonist i ngjarjeve ekspozuese dhe kulturore nga vitet 1970 e deri më sot; promovues aktiv i artit pamor në Shqipëri dhe në SHBA; pedagog i artit pamor, personalitet në jetën tonë artistike; piktor kreativ i qindra kompozimeve tematike; interpretues cilësor i elementeve të krijimtarisë figurative; piktor i shquar dhe kolorist unik i 50-të pikturave në vaj, kushtuar

personalitetit të shquar të letrave shqiptare Ismail Kadare; vlerësuar me disa çmime e mirënjohje, brenda e jashtë vendit.

- Rafet Rudi, kompozitor, dirigjent

Me motivacionin:

Kompozitor, dirigjent dhe muzikolog i shquar i muzikës mbarëshqiptare, veçanërisht asaj në Kosovë; protagonist i ngjarjeve më të rëndësishme muzikore, artistike e kulturore nga vitet 1970 e deri më sot; promovues aktiv i bashkëpunimeve muzikore mes Kosovës dhe Shqipërisë; pedagog dhe personalitet publik me peshë të veçantë në jetën tonë muzikore; interpretues i krijimtarisë muzikore të kompozitorëve shqiptarë në skena të rëndësishme të botës, përmes formacioneve muzikore vokale e instrumentale; mbështetës dhe inkurajues i brezave të rinj të krijuesve e interpretuesve; vlerësuar me disa çmime kombëtare e ndërkombëtare; themelues i festivalit të rëndësishëm muzikor REMUSICA.

2. T'i jepet mirënjohja Nderi i Akademisë (pas vdekjes), studiuesit dhe personalitetit të shquar në fushën e matematikës,

- Prof. Mina Naqo

Me motivacionin:

Për meritat e tij si matematikan dhe mësimdhënës në degën e matematikës, erudit me horizont të gjerë në matematikë dhe astronomi; autor i teksteve bazë për universitetin por edhe popullarizimin e shkencës dhe matematikës; hartues i programeve dhe teksteve të para për teorinë e probabiliteteve dhe statistikës matematike, zbatimet e analizës funksionale në fushën e statistikës matematike, astronomi etj.; bashkautor i projekteve kombëtare për ndërtimin e rrjetit të parë informatik dhe të rrjetit të informacionit teknik e shkencor; bashkautor në riorganizimin e institucioneve shkencore (drejtues i suksesshëm në institucione të rëndësishme si Ministria e Arsimit, Akademia e Shkencave, Komiteti i Shkencës dhe Teknikës); kudo i vlerësuar për kontributin e gjithanshëm si kërkues, edukator dhe organizator i suksesshëm, duke lënë mbresa të shkëlqyera veçanërisht tek studentët e vet.

3. Mirënjohja Nderi i Akademisë të jepet përmes një ceremonie publike të organizuar sipas përshkrimit në Rregulloren për ceremonialin dhe solemnitetet; për personalitetin e muzikës, kompozitorin dhe dirigjentin Rafet Rudi, mirënjohja t'i jepet më datë 4 dhjetor 2025, në aktivitetin e promovimit të dy librave të tij, në Akademinë e Shkencave; ndërsa për dy personalitetet e tjera, matematicienin

prof. Mina Naqo dhe piktorin Bashkim Ahmeti, mirënjohja të jepet në aktivitete të cilat do të zhvillohen nga Akademia e Shkencave, në një kohë sa më të afërt.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetarët e dy seksioneve dhe kancelari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

